

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, me s. juridike, Shefinaze Sahiti, çështjen juridiko-civile të paditësit, H. H, nga f. Zh, , sipas të autorizuarës, Vlora Spahiu, jur. nga Gjilani, ndaj të paditurit, E. R, nga Gj, pa nunër, sipas të autorizuarës, Arbra Shala, jur. nga Gjilani, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë - Lokalit, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.19.06.2017 bie këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar, kërkespacia e paditësit, H. H, nga f. Zh, ndaj të paditurit, E. R, nga Gj dhe **VËRTETOHET** se paditësi në bazë të kontratës për shitblerjen e lokalit,, e vërtetuar më dt.23.11.2010, nga Gjykata Komunale në Gj është pronarë i Lokalit nr. 55-3, në sipërfaqe prej 70 m², i cili gjendet në objektin Banesor „... „, në katin e tretë, i ndërtuar në ngas.kad.nr.P-70403013-3305-0, në Gjilan dhe **DETYROHET**, i padituri, E. R, nga Gj, t ia njohin paditësit, të drejtën e pronësisë, të përmbahet dhe durojn ashtu që paditësi Lokalin e cekur më lart, ta evidentoi në regjistrin e banesave në emër të tijë në DGJKPB, në Gjilan, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmabrimit të detyruar.

II. DETYROHET, pala paditëse ta paguajnë taksën gjyqësore shtesë, në lartësi prej 35,00 €, e llogaritur në raport me vlerën e kontestit.

III. Në baz të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontesdtimore. ndërsa detyrohet pala paditëse ta paguajnë taksën shtesë në lartësi prej 35,00 €, në raport me vlerën e kontestit.

A r s y e t i m

Paditësi, H. H, nga f. Zh, me padinë e ushtruar më dt., kësaj gjykate, kishte konfirmuar se në bazë të kontratës mbi shitblerjen e Lokalit, ..., e vërtetuar më dt.23.11.2010, nga Gjykata Komunale në Gjilan, lokalin afarist e ka bler prej shitësit, E. Ri, nga Gj, për çmimin kontraktues në lartësi prej 14.000,00 € dhe pas pagesës së çmimit kontraktues, shitësi ia kishte dorëzuar blerësit çelësat e Lokalit, në posedim dhe shfrytëzim të papenguar nga vitit 2010 e deri më tani.

E autorizuar e paditësit, V.S , nga Gj, në seancën kryesore të mbajtur më dt.19.06.2017 dhe seancat tjera kishte deklaruar se çëndroi pran padisë dhe kërkespadiës, i propozoi gjykatës që pas administrimit të gjitha provave nga lënda dhe pas vërtetimit të gjenjdjes faktike gjykata të bie aktgjykim meritor me të cilin në tërësi do ta aprovoi kërkespadinë e paditësit si të bazuar dhe t ia njohin paditësit të drejtën e pronësisë për lokalin kontestuese, ashtu që paditësi të evidentohet në regjistrin e DGJKPB, në Gj si pronar juridik, i lokalit afarist.

E autorizuar e të paditurit, A. Sh jur. nga Gj, në seancën kryesore, më dt. dhe seancat tjera kishte deklaruar, se e pranoi dhe pohoi kërkespadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe i propozoi gjykatës që pas vërtetimit të gjendjes faktike për zgjidhjen e çështjes kontestuese të bie aktgjykim merititor.

Të autorizuarat e palëve ndërgjyqëse i propozojn gjykatës të administrohen të gjitha provat nga lënda dhe të dëgjohet eksperti gjeodet B. K, nga Gj.

Në bazë të neneit 8 të LPK-ës, gjykata në shqyrtimin kryesor e ka dëgjuar ekspertin gjeodet Bujar Kurteshi dhe i ka lexuar - administruar të gjitha provat, nga lënda, si vijoi:

1. Eksperti gjeodet, B.K, nga Gj në seancën kryesore të mbajtur më dt.19.06.2017, deklaroi qëndroi pran konstatimit me skicën e hartuar të dt.14.02.2016, dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e gjyqtarit dhe plëve ndërgjyqëse.

Në pyetjen e gjyqtarit, eksperti deklaroi se gjendja faktike e sipërfaqes së lokalit në tërësi përputhem me gjendjen juridike, sipas Kontratës së Shitblerjes dhe lokali kontestues e ka sipërfaqen prej 70 m², duke e llogaritur edhe 1/2 e gjersisë së murit të banesës.

Në bazë të neneit 8 të LPK-ës, gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga lënda si vijoi:

- Lexohet dhe administrohet, Kontrata për shitblerjen e lokalit, ..., e vërtetuar më dt.23.11.2010, nga Gjykata Komunale në Gj Nga kjo provë gjykata konstatoi se paditësi H. H e ka bler lokalin kontestues prej E. R për çmimin kontraktues në lertësi prej 40.000,00 € dhe paditësi është në shfrytëzim dhe posedim, si pronarë faktik i Lokalit nr.55-3, në sipërfaqe prej 70 m², në objektin Banesor ,,..., në katin e tretë, i ndërtuar në ngas.kad.nr.P-70403013-3305-0, në Gj

- Lexohet dhe administrohet, Deklarat nën betim e të paditurit E. R, nga Gj, e hartuar sipas nr..., e vërtetuar më dt. 20.01.2017, te Noteri, nga i. Nga kjo provë gjykata konstatoi se shitësi E.R ia ka shitur lokalin afarist blerësit H. H, nga f. Zh

- Lexohet dhe administrohet, Kontrata për shitblerjen e lokalit, Vr.nr..., e vërtetuar më dt.26.05.2009, nga Gjykata Komunale në Gj. Nga kjo provë gjykata konstatoi se blerësi, e ka bler lokalin kontestues prej shitësit, për çmimin kontraktues në lertësi prej 14.000,00 €.

- Lexohet dhe administrohet, Aktvendimi nr., i lëshuar më dt...., nga DGJKPB, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se është refuzuar kërkesa e Hysen Hysenit për regjistrimin e lokalit kontestues në emër të tij.

- Lexohet dhe administrohet, Konstatimi me skicë të hartuar nga vendi i ngjarjes i dt.14.02.2017, prej ekspertit gjeodet,. Nga kjo provë gjykata konstatoi se gjendja faktike e sipërfaqes së lokalit afarist përputhet me gjendjen juridike sipas kontratës së shitblerjes dhe lokalitn e shfrytëzon paditësi Hysen Hyseni, nga f. Zh., Komuna e Gj.

Gjykata pasi i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat në hollësi veç eveç në ralcionin krahasues pas vlerësimit të gjitha provave si tërësi, e ka arritur qëndrimin juridik dhe e ka konstatuar gjendjes faktike si vijoi:

- Në mes palëve nuk është kontestuese shitblerja e loklait kontetuese për çmimin kontraktues.

- Me leximin e kontratës me shkrim për shitblerjen e lokalit, gjykata konstatoi se paditësi H.H e kishte bler Lokalit kontestuese prej të padituirit E. R dhe pas përmbushjes së detyrimeve kontraktues pagesën e tërësishme të çmimit kontraktuese, shitësi ia kishte dorëzuar blerësit loklain afarist në shfrytëzim dhe posedim.

Pas administrimit të gjitha provave kontratave të shitblerjes të nënshkruara me vullnetin e palëve kontraktuese, lokali kontestues ishte shitur për çmimin kontraktues dhe ishin përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuese, për çka këtë rrethanë e vërtetojnë edhe provat e bashkangjitura si në lëndë, ndërsa paditësi tani është pronar faktik i lokalit kontestues, pasi e shfrytëzon i pa penguar nga i padituri, familja e tijë apo personat e tretë.

E autorizuar e të paditurit, ..., ka deklaruar se në tërësi e pranoi padinë-kërkespandinë e paditësit si të bazuar.

Nga të cekurat më lart, pas vërtetimit të gjendjes faktike gjykata ka ardhur në përfundim dhe vendosi që në tërësi ta aprovoi kërkespandinë e paditësit si të bazuar, për shkak se paditësi dhe i padituri pas përmbushjes të obligimeve të ndërsjellta kontraktuese, në bazë të punëve juridike, kontratës për shitblerjen e loklait, paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë, ndërsa pala e paditur e ka pohuar dhe pranuar kërkesoadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe për këtë gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta, të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Palët ndërgjyqëse kishin deklaruar se heqin dorë nga ankesa ndaj këtij aktgjykimi, i cili është i plotfuqishëm, nga dita e pranimit të të njejtit, nga palët ndërgjyqëse.